



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 307/19
321/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Blerim Dina– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesave të parashtruara nga operatorët ekonomik “Renelual Tahiri” - Prizren, dhe OE “G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi” – Prizren, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Euro Via” – Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me zhavorr për rrugët e paasfaltuara ne Komunën e Prizrenit”, me numër të prokurimit: 622-19-1256-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Prizren, më datën 23.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: “Renelual Tahiri” - Prizren, dhe OE “G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi” – Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me zhavorr për rrugët e paasfaltuara ne Komunën e Prizrenit”, me numër të prokurimit: 622-19-1256-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Prizren.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “Furnizim me zhavorr për rrugët e paasfaltuara ne Komunën e Prizrenit”, me numër të prokurimit: 622-19-1256-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Prizren, dhe lënda kthehet ne **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesat e operatoreve ekonomik ankues“Renelual Tahiri” - Prizren, dhe OE “G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi” - Prizren,aprovohen si pjesërisht tëbazuar, ju bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 21.03.2019.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 21.03.2019.

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 30.04.2019.

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 28.05.2019.

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar është bërë me dt: 31.05.2019.

Data e vendimit të AK-së, për dhënie të kontratës është bërë me dt: 31.05.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim e OE “Renelual Tahiri” - Prizren,është bërë me dt: 03.06.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim e OE “G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi” – Prizren,është bërë me dt: 04.06.2019.

Data e vendimit të AK-së, lidhur me kërkesën për rishqyrtim të “Renelual Tahiri” – Prizren është bërë me dt: 06.06.2019.

Data e vendimit të AK-së, lidhur me kërkesën për rishqyrtim të “G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi” – Prizren,është bërë me dt: 06.06.2019.

Operatori ekonomik ankues “Renelual Tahiri” - Prizren,si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 13.06.2019, me nr prot: 307/19, ndërsa Operatori ekonomik “G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi” – Prizren,si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me datën 17.06.2019, me nr prot: 321/19,kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:“Furnizim me zhavorr për rrugët e paasfaltuara ne Komunën e Prizrenit”, me numër të prokurimit: 622-19-1256-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Prizren, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues sipas OE- ankues,“Renelual Tahiri” - Prizren, ka vepruar në kundërshtim me nenin1, 6, 7, 10, 53,59, 60, 69, dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së

Kosovës.

- Autoriteti kontraktues sipas OE-ankues “G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi” – Prizren, ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,6,7, 10,59, 69, dhe 72, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 4 dhe 39 të RrUOOP-së, si dhe vendimet e OSHP-së, PSH nr.104/18, PSH nr.197/16, PSH nr.448/15, dhe PSH nr.193/18.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 19.06.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e datës: 04.07.2019, ka sqaruar pretendimet e OE ankues, “Renelual Tahiri” – Prizren, sqaron se OE ankues eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vilet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri. data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1,500.000.00€.

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, ne dosje te tenderit ka kërkuar lidhur me kontratat dhe referencat ka kërkuar “Projektet e natyrës së kontratës....”.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues “Renelual Tahiri”, ne ofertën e tij ka dorëzuar kontrata dhe referenca në asfaltim te rrugëve, ndërtim te rrugëve, meremetim te rrugëve, ndërtim me elemente te betonit te rrugëve, ne vlerë prej mbi 4.500.000.00 €.

Duke u bazuar ne kërkesën e dosjes se tenderit - "Projektet e natyrës së kontratës....", eksperti shqyrtues, vlerëson se pa u kërkuar sqarime për secilën kontratë te dorëzuar ne ofertë nuk mund te gjendet vlera e saktë e furnizimit me zhavorr apo edhe te pjesëve tjera të përfshira ne paramasë te këtij projekti.

Eksperti Shqyrtues në raportin e datës: 04.07.2019, ka sqaruar pretendimet e OE ankues, “G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi” – Prizren, sqaron se OE ankues eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se: Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1.500.000.00 €.

Nuk e keni plotësuar në ofertë çmimin e përgjithshëm të peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të

kësaj vlere). Në bazë nenit 52 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues, sa i përket arsyes se pare te eliminimit ngjashëm sikurse te sqarimin i dhënë me lart konstaton se nuk mund te nxirret vlere e saktë e projekteve te natyrës se kontratës pa e verifikuar saktë listën e kontratave dhe referencave për faktin se edhe OE ankues “G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi”, ka ofruar projekte ne ndërtim asfaltim le rrugëve.

Lidhur me arsyen e dytë te eliminimit, eksperti shqyrtues sqaron se Oe ankues nuk e ka plotësuar ne tërësi paramasën dhe parallogarin. Konkretisht OE ankues ne pjesën ku është dashur te jep edhe çmimin e peshuar ne përshkrim te çmimit e ka lënë te zbrazet. Eksperti shqyrtues vlerëson se një situatë e tillë nuk është e përcaktuar me dispozitat e LPP-se, përveç një interpretimi te dhënë ne pyetjen nr. 29 te publikuar ne ueb faqen e Krpp-së, ku thuhet se:

Nëse Operatori Ekonomik nuk plotëson një nga pozicionet në Listën e Përshkrimit të Çmimeve, tenderi duhet të refuzohet, pasi që tenderi gjithmonë duhet të jetë në përputhje me qëllimin e i plotë të kontratës .

OE ankues “G-Solutions &G-Projeel&Joos Krasniqi”, ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e te rekomanduarit për kontratë, për te cilin pretendon se nuk i ka ofruar pajisjet sipas kërkesave te dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë, konkretisht pretendon se ne dosje janë kërkuar dy cilindra me peshë nen 10t. Ky pretendim nuk qëndron për faktin se ne kërkesë te dosjes se tenderit kërkohej dy cilindra për ngjeshje një tonazhit të mesëm deri 10 ton dhe një tonazhit të rëndë mbi 10 ton. OE i rekomanduar për kontratë ne ofertën e tij për këtë pajisje i ka dorëzuar dëshmitë për cilindrata por ne shënimet e dhëna thuhet:

Kapaciteti 15000, pa e përcaktuar se çka do te thotë 15000, prandaj eksperti shqyrtues, vlerëson se pajisjet ne fjalë duhet te verifikohen nga AK-ja, konform nenit 72 te LPP-së, se a janë sipas kërkesës se dosjes se tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Po ashtu lidhur me pajisjet e ofruara nga i rekomanduari për kontratë,OE ankues pretendon edhe për 4 kamionët dhe 3 buldozheret nuk e plotësojnë kërkesën c AK-se, eksperti shqyrtues, sqaron se edhe te pajisjet lartpërmendura ka paqartësi lidhur me kapacitetin e pajisjeve, dhe bazuar ne faktin se pajisjet kanë paqartës: AK-ja, është dashur ti verifikojte konform nenit 59 dhe 72 te LPP-së, për faktin se AK-ja sipas nenit 59 do ta konsideroj te përgjegjshme vetëm ofertën e cila është ne përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Sa i përket pretendimit te OE ankues lidhur me inxhinierin z.Sejdullah Pulaj, eksperti shqyrtues. sqaron se ky pretendim është i paqëndrueshëm për faktin se AK-ja, ka kërkuar ne dosje te tenderit qe “për stafin e rregulltlista e ATK së bashkë me kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt”, ne kontratën e dorëzuar nga i rekomanduari për kontratë për inxhinierin ne fjalë, kontrata rezulton te jetë nga

janari i vitit 2019, deri ne fund te vitit 2019. pra me afat te caktuar qe do le thotë se nuk është i angazhuar ne kompaninë “Eurovia” si staf i rregullt.

Eksperti shqyrtues ne fund te analizimit dhe shqyrtimit te pretendimeve ankimore sqaron se AK-ja. Gjatë vlerësimit të ofertave nuk i ka përdor mundësit ligjore qe i jep LPP-ja, konkretisht nenin 72 dhe 59 te LPP-së, lidhur me sqarimet e kontratave te OE-ve ankues dhe po ashtu lidhur me ofertën e te rekomanduarit për kontratë, prandaj për te nxjerr një përfundim me te saktë është e nevojshme te verifikohen dëshmitë e përmendura me lart.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve, ankues të aprovohen pjesërisht si te bazuar, ndërsa vendimi i AK-së, për dhënie të kontratës te anulohet dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Operatori ekonomik - “Renelual Tahiri” - Prizren, përmes parashtresës me shkrim të datës: 04.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues, KK Prizren, përmes parashtresës me shkrim të datës: 04.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23.07.2019, ku kanë qenë prezent kryetari i paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për anulim të aktiviteti te prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së “Renelual Tahiri z. Shabani deklaroi: Ky AP ne njoftimin për kontrate është dashur qe hapja e tenderit është dashtë të behet me date 30.04.2019 pas analizës se kësaj dosje ne kemi kërkuar menjëherë info pran Autoriteti Kontraktues ne dëshminë ku thuhet lista e projekteve te kontratës për 3 vitet e fundit për dosjen e elektronike te dëshmuar me referenca qe dëshmoje vlerën e punëve ne natyrën e tyre apo procesverbal përfundimtar. Pyetja jone ka qen a saktësisht te na sqarojnë se vlejné projektet e rrugëve te ndërtuara ku ne secilën nga to ceket shtruarja ngjeshja e zhavorrit punimi i betonit te gjitha këto te natyrës se njëjtë sipas kontratës. Pika tjetër sqaruese për Autoriteti Kontraktues ka qen nga Autoriteti Kontraktues, ka qenë qe OE i propozuar për kontrate qe ka dëshmi qe ka gurethyesin qe është jo me shume se 15 Km nga qyteti, ne ketë e kemi par si diskriminuese

siç kërkohet mbase Prizreni kufizohet me territor shume km qe i bie gurethyesin ta ketë brenda vendbanimeve. Na është dashur te presim rreth një (1) muaj për info shtese gjegjësisht për informacion apo përmirësim të gabimit.

Pika e kësaj largësie qe ta ketë gurthyesin është eliminuar kurse lista e projekteve nuk na është dhëne sqarim për ketë por është vazhduar me siç është kërkuar ne DT me kontrata te natyrës se njëjte për ne paraqet një shkelje ne paqartësi. Nuk vlejné këto kontrata apo nuk vlejné, ne kemi pas mundësi ne ketë afat te gjejmë OE tjetër për këtë kriter. Mendojmë qe këtë kriter e plotësojmë edhe sipas Eksperti Shqyrtues. Ne kemi kontrata mbi 4.5 milion kurse është kërkuar 1.5 milion me kontrata dhe pranim me procesverbal.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së "G-Solutions & G-Projeel&Joos Krasniqi" z. Rexhepi deklaroj: Fillimisht mbetem ne tërësi pran ankesës se parashtruar, sa i përket mendimit te ekspertit te njëjtin, me te njëjtin pajtohem i pjesërisht sa i përket rekomandimit qe lënda te kthehet ne rivlerësim mirëpo kemi vërejtje sa i përket shqyrtimit te vërejtjeve tona ankimore për shkak se pretendimet tona ankimore nuk janë shqyrtuar ne mënyrë te drejt nga eksperti pran panelit edhe një here do ta elaboroj ankesën tone dhe do te paraqes vërejtjet ne lidhje me ekspertizën e ekspertit. Pik se pari ne ankesën qe e kemi paraqitur ne i kemi paraqitur 3 vendime te panelit ata 104/18, 197/16 dhe 448/15, te cilat ne mënyrë te qarte precizojné dhe vërtetojnë se mosplotësimi i çmimit total i peshuar nuk mund te jetë bazë qe një OE te shpallet i papërgjegjshëm edhe një here potencoj se ne i kemi pasur te theksuar çmimin për njësi dhe çmimin ne total dhe sipas çmimit për njësi dhe total kemi qen OE dukshëm me i lire. Eksperti ne mendimin e tij gabimisht ne mënyrë te paqëllimshme apo pa dijeni thirret ne një interpretim te dhen nga KRPP ne te cilin thotë se " nëse OE nuk plotëson një nga pozicionet ne listën e përshkrimit te çmimeve tenderi duhet te refuzohet pasi qe tenderi gjithmonë duhet te jetë ne përputhje te plote ne qëllimin e plote te kontratës" siç shihet këtu theksohet se ne rast qe nuk plotësohet një nga poz. OE i ka pasur te plotësuar te gjitha pozicionit mirëpo nuk e ka plotësuar çmimin total te peshuar për shkak qe formula për përlllogaritjen e te njëjtit ka qen e gabuar për ta dëshmuar këtë panelit dhe përfaqësuesit te Autoriteti Kontraktues ju ofroj dëshmitë përkatëse, ku kjo lehtësisht mund te vërtetohet ne sistemin e-prokurimit. Po ashtu shtoj se Eksperti Shqyrtues. Nuk ka adresuar një nder pretendimet kyçe ne lidhje me aplikimin e formulave ne exel te Autoriteti Kontraktues për deri sa çmimet ishin te peshuara sipas përshkrimit 35, 25, 20, 15, dhe 5% ne exel sipas DT-së ne formulat e llogaritjes se çmimit këto formula ishin paraqitur ndryshe gabimisht dhe kalkuloni vlere me përqindje tjera atë si ne vijim 20, 15, 10 dhe 5% qe do te thotë po te plotësohej çmimi i peshuar do te jepej një çmim i ndryshëm nga ai i përshkruar nga OE qe unë e përfaqësoj. Sa i përket referencave te ofruara ne vlere prej 1.5 euro te natyrës se kontratës OE qe

përfaqësojnë ka vlerësuar se natyra e njëjtë e kontratës është çdo punë e parapare në DT e këtopërfshin: furnizim me zhavorr, pastrim i terrenit gjurmimi i kanaleve vendosja e gypave furnizimi me koka hyrëse dhe dalje me beton pastrimi i kanaleve të hapura në forme trapezi furnizim me material si dhe punim i armaturës dhe betonim i mureve mbrojtëse. Në përputhje me kërkesat e paramasë së DT OE që unë përfaqësoj ka ofruar një listë me 74 projekte në vlerë prej mbi 12 MLN euro ku nga kjo vlerë mbi 2 MLN janë punë të natyrës së kontratës andaj konsiderojmë se edhe këtë kërkesë e kemi plotësuar në tërësi.

Me tutje dëshiroj të paraqes edhe faktet dhe arsyet se përse OE i rekomanduar për kontratë “Euro Via” SH.P.K është i përgjegjshëm. 2 cilindrat në ofertën e tij janë me kapacitet mbi 10 Ton, në DT është kërkuar që njëri nga këta cilindra të jete nën 10 Ton, 3 buldozheret e OE të rekomanduar janë me peshe si në vijim: 13.55, 18.55 dhe 24.45 Ton ndërsa kërkesa sipas DT-së ka qenë që njëri nga këta buldozer të jete nën 10 tone, kërkesë të cilën OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar. 4 Kamion të kërkuar me peshe deri në 10 Ton sipas DT-së OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka pasë të gjitha pajisjet e regjistruara e tejkalojnë dukshëm peshën 10 tone sipas përshkrimit që ka bre vet OE.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Mustafaj deklaroj: Fillimisht tek pretendimit të Renuat tahir, ku përfaqësuesi i saj tha nuk na është përgjigje, çfarë do përgjigje që udhëzon të një përshkrim i caktuar nga DT është përgjigje e plote. Nëse kriteri kish me qenë i pa kartë atëherë aty mund të diskutohet por deri sa kriteri ka qenë i përshkruar ashtu siç është në e kemi udhëzuar OE-në që të përmbahet kriterëve të DT-së dhe njoftimit për kontratë. Pjesa tjetër e gurethyesit që të mos ethe me shumë se 15 Km ka qenë që edhe neve po na bëhet diskriminim i OE ve të tjera edhe e kemi hekur këtë kriter. Arsyeja e eliminimit të OE ka qenë referencat e natyrës së kontratës dhe komisioni atëherë ka pas mundësi prej të gjitha kontratave të prezantuara nga OE ankues, i ka nxjerr të gjitha pozicionet e paramasës. Edhe për të gjitha rrugët i ka nxjerr të natyrës së kësaj natyre, vlera e përgjithshme që ka prezantuar “reneluali” ka qenë rreth 1.3 milion, kërkesa jone ka qenë 1.5 MLN.

Tek pretendimit të OE-së së 2-të ankues G-Solution: Arsye eliminimit është se nuk e ka plotësuar listën e çmimeve ashtu siç duhet, lista e pa plotësuar apo e plotësuar me gabime nuk pranohet. Arsye të tjera akuzojnë Autoriteti Kontraktues se nuk i ka përgatitë në excel. Nëse nuk aplikohet formulari standard por aplikohet ndonjë formular tjetër për çmime Autoriteti Kontraktues mund të ngris parametren të punuar edhe në Word edhe në PDF që i lejon ligji i për prokurim publik. Nuk është e vërtetë formula që e citoj përfaqësuesi ankues, si do që të jetë OE ankues para ngritjes së çdo dokumenti qoftë të formularit C, listës së çmimeve duhet të kontrollojë a është plotësuar mirë e pastaj ta ngrisë. Sipas Autoriteti Kontraktues OE i rekomanduar i plotëson të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi OE-së“Renelual Tahiri z. Shabani deklaroj: Kërkojmë qe ankesa jone te aprovohet dhe lënda te kthehet ne rivlerësime.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi OE-së“G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi”,z. Rexhepi deklaroj: Kërkojmë qe ankesa jone te aprovohet si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Osmankaj deklaroj: Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: Kërkojmë qe te hudhen poshtë ankesat e OE-ve, ankuese si te pa bazuara dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE-ve ankuese, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankues “Renelual Tahiri” – Prizren, pretendon se është eliminuar nga autoriteti kontraktues KK Prizren, me arsyetimin si ne vijim : Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1,500.000.00€.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetit kontraktues, ne dosje te tenderit ka kërkuar lidhur me kontratat dhe referencat “Projektet e natyrës së kontratës..”. pra natyra e kontratës është furnizim me zhavorr ndërsa si dëshmi AK, ka kërkuar pune te realizuara te natyrës se kontratës dhe OE ankues “Renelual Tahiri”, ne ofertën e ka dorëzuar kontrata dhe referenca në asfaltim te rrugëve, ndërtim te rrugëve, meremetim e rrugëve, ndërtim me elemente te betonit te rrugëve ne vlerë prej mbi 4,500,000.00€ qe do te thotë se e ka plotësuar kërkesën e AK-se me dëshmi te kërkuara. Vetë termi i përdorur nga AK “natyra e kontratës” nuk len hapësirë për te dyshuar se OE ankues nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të AK-së, pasi që, nëse e shikojmë paramanës për këtë aktivitet, pothuajse të gjitha pozicionet janë te njëjta me pozicionet e ndërtimit te rrugëve, pra natyra e kontratës është punët qe kryhen e jo titulli qe emërtohet projekti.

Me poshtë po e paraqesim këtë kërkesë te AK-se sipas dosjes se tenderit:

Kërkesat	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
----------	-----------	------------------------------------	--------------------------------

mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1.500.000,00 €	Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të punëve.
--	---	--

Sa përket pretendimit të OE ankues “G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi”se është eliminuar nga autoriteti kontraktues KK Prizren, me arsyetimin si ne vijim: Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1.500.000.00 €.Nuk e keni plotësuar në ofertë çmimin e përgjithshëm të peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë tëkësaj vlere). Në bazë nenit 52 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se sa i përket arsyes se pare te eliminimit ngjashëm sikurse te sqarimin i dhënë me lart për faktin se edhe OE ankues “G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi”, ka ofruar projekte ne ndërtim asfaltim të rrugëve.

Ndërsa lidhur me arsyen e dytë te eliminimit, ne pjesën ku është dashur te jep edhe çmimin e peshuar ne përshkrim te çmimit e ka lënë te zbrazet. Andaj një situatë e tillë nuk është e përcaktuar me dispozitat e LPP-së, Paneli shqyrtues e konsideron si devijim te vogël pasi qe kontrata mund te implementohet sepse OE ankues ka dhënë çmime per njësi ne te gjitha pozicionet.

Sa përket pretendimit të OE ankues “G-Solutions &G-Projeel&Joos Krasniqi”, se OE i rekomanduarit për kontratë“Euro Via” – Prizren,nuk i ka ofruar pajisjet sipas kërkesave te dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë, konkretisht se ne dosje të tenderit janë kërkuar dy cilindra me peshë nen 10t. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pretendim i lartpërmendur nuk qëndron për faktin se ne kërkesë te dosjes se tenderit kërkohen dy cilindra për ngjeshje një tonazhit të mesëm deri 10 ton, dhe një tonazhit të rëndë mbi 10 ton. Ndërsa, OE i rekomanduar për kontratë ne ofertën e tij për këtë pajisje i ka dorëzuar dëshmitë për cilindrart por ne shënimet e dhëna thuhet:Kapaciteti 15000, pa e përcaktuar se çka do te thotë 15000. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pajisjet ne fjalë duhet te verifikohen nga AK-ja, KK-Prizren, konform nenit 72 të LPP-së, se a janë sipas kërkesës se dosjes se tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Sa i përket pretendimit OE ankues “G-Solutions &G-Projeel&Joos Krasniqi”, se pajisjet e ofruara nga OE i rekomanduari për kontratë, të cilat janë katër (4) kamionët dhe tre (3) buldozerët nuk e plotësojnë kërkesën e AK-se. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se edhe te pajisjet e lartpërmendura ka paqartësi lidhur me kapacitetin e pajisjeve, dhe bazuar në faktin se pajisjet kanë paqartësi: AK-ja, është dashur ti verifikojë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së, për faktin se AK-ja sipas nenit 59 të LPP-së, do ta konsideroj të përgjegjshme vetëm ofertën e cila është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Sa i përket pretendimit të OE ankues “G-Solutions &G-Projeel&Joos Krasniqi”, lidhur me inxhinierin z.Sejdullah Pulaj. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendim i lartpërmendur është i paqëndrueshëm për faktin se AK-ja, ka kërkuar në dosje të tenderit që “për stafin e rregullt lista e ATK së bashkë me kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt”, në kontratën e dorëzuar nga i rekomanduari për kontratë “Euro Via” – Prizren, për inxhinierin në fjalë, kontrata rezulton të jetë nga janari i vitit 2019, deri në fund të vitit 2019, pra me afat të caktuar që do të thotë se nuk është i angazhuar në kompaninë “Eurovia” si staf i rregullt.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues KK Prizren, gjatë vlerësimit të ofertave në këtë aktivitet të prokurimit nuk i ka përdorur mundësitë ligjore që i jep Ligji për Prokurimin Publik, konkretisht nenin 72 dhe 59 të LPP-së, lidhur me sqarimet e kontratave të OE-ve ankues dhe po ashtu lidhur me ofertën e të rekomanduarit për kontratë, prandaj për të nxjerrë një përfundim me të saktë është e nevojshme të verifikohen dëshmitë e përmendura më lart.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha shkresat e lëndës si dhe në sqarimet e ekspertit shqyrtues vjen në përfundim se autoriteti kontraktues KK- Prizren, ekzaminimi, vlerësimin dhe krahasimi e ofertave nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së. Prandaj, obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, Njëkohësisht autoriteti kontraktues, KK- Prizren, ti verifikojë dhe të kërkojë sqarime shtesë për të gjitha dëshmitë-dokumentet, pajisjet dhe referencat (e OE-së, të rekomanduar për kontratë “Euro Via” – Prizren), të cilat i konteston operatori ekonomik ankues, ashtu siç u cek më lartë, më saktësisht të vërtetojë se OE në fjalë a ka ofertuar konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më

të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –Komuna Prizren

1x1 OE- “Renelual Tahiri” - Prizren,

1x1 OE- “G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi” – Prizren

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.